



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.180/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj kryesues, Kymete Kicaj e Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Nasa Bosnjačka Koalicija, me seli në Prizren, kundër subjektit politik Nova Demokratska Stranka, me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 26.01.2025, mori këtë:

### **V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa Anr.180/2025 datë 24.01.2025 e parashtruar nga subjekti politik Nasa Bosnjačka Koalicija, me seli në Prizren, kundër subjektit Nova Demokratska Stranka, me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

### **A r s y e t i m**

Me datë 24.01.2025, PZAP- i, ka pranuar një ankesë, nga subjekti politik Nasa Bosnjačka Koalicija, me seli në Prizren të parashtruar kundër subjektit politik Nova Demokratska Stranka, me seli në Prizren, për shkelje të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e përgjithshme dhe Kodin e Sjelljes së Subjekteve Politike, për shkak se Në tubimin e organizuar nga Partia e Re Demokratike më 23 janar 2025 në komunën e Pejës, në restorantin Eleganca në Vitomiricë, kandidati i kësaj partie për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Abaz Ademi, ka bërë një sërë deklaratash fyese dhe shpifëse. Gjatë fjalimit të tij, kandidati akuzoi pa prova anëtarët e partisë sonë, duke i quajtur “pedofilë” dhe “mjekroshë”. Deklarata të tilla jo vetëm që dëmtojnë nderin dhe reputacionin e anëtarëve tanë, por gjithashtu paraqesin një sulm serioz ndaj parimeve themelore demokratike.

Pala ankuese po ashtu thekson se një sjellje e tillë kërkon reagimin e autoriteteve kompetente dhe sanksionet e duhura në përputhje me ligjin, për të parandaluar përsëritjen e rasteve të ngjashme në të ardhmen. I bëjmë thirrje institucioneve që të trajtojnë me seriozitet dhe përgjegjësi akte të tilla, sepse cenojnë dinjitetin dhe dëmtojnë jo vetëm individët, por edhe të gjithë diskursin shoqëror. Ne

presim gjobën maksimale për këtë subjekt politik, sepse shpifje, fyerje dhe gjuhë të tilla urretjeje nuk duhet të tolerohen në një shoqëri demokratike.

Në përgjigje në ankesë të datës 24.01.2025 nga subjekti politik LVV, theksohet se i refuzojmë kategorikisht të gjitha pretendimet e bëra si të pavërteta dhe të pabaza. Në ngjarjen në fjalë nuk u përmendën emra kandidatësh apo partish të opsioneve të tjera politike, por takimi i dedikohet ekskluzivisht prezantimit të programit tonë dhe planeve për të ardhmen. Theksojmë se asnjë kandidat i partisë sonë politike nuk përmendi apo komentoj punën e opsioneve të tjera politike gjatë ngjarjes së përmendur. Aktiviteti u organizua me qëllim që të prezantojmë programin tonë politik, të bisedojmë me qytetarët dhe të paraqesim plane konkrete për përmirësimin e komunitetit lokal. Gjatë gjithë veprimtarisë, kandidatët tanë iu përmbajtën standardeve më të larta etike dhe profesionale, duke promovuar vetëm idetë dhe vizionet e tyre, pa iu referuar subjekteve të tjera politike. Regjistrimi konfirmon qartë se asnjë deklaratë që mund të interpretohet si ofenduese për subjektet e tjera politike nuk u shqiptua. Tutje kanë shtuar se kjo ankesë është tentativë për të dezinformuar opinionin dhe për të dëmtuar reputacionin e partisë sonë politike para zgjedhjeve të ardhshme. U bëjmë thirrje institucioneve kompetente, përfshirë Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) dhe Komisionin për Organizimin dhe Kontrollin e Zgjedhjeve (KQZ), që të marrin parasysh të gjitha faktet dhe provat materiale relevante gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë.

PZAP pasi që shqyrtoi ankesën vlerësoi se :

**-Ankesa është e pabazuar.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoi se pretendimet e subjektit politik Nasa Bosnjačka Koalicija, me seli në Prizren, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërit si në vijim: *përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urretje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*”.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik Nova Demokratska Stranka, me seli në Prizren, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që parashtruesi i ankesës, në ankesë e ka cituar fjalimin e kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës Abaz Ademi, ku sipas ankuesit, i njëjti, në tubimin e mbajtur në Vitomiricë, me datë 23 Janar, ndër të tjera ka deklaruar se “ anëtarët e partisë ankuese, duke i quajtur “pedofilë” dhe “mjekroshë””, pasi që nga fotografitë e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se si a ndodhur shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga

provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë, pasi që nuk ka ofruar asnjë provë për vërtetimin e këtyre shkeljeve.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nënin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 180/2025 më datën 26.01.2025

**Kryesues i Panelit,  
Arsim Hamzaj**



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.